



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 04/1 Prot.

Tiranë, më 15.01.2026

VENDIM

Nr. 4 , datë 09.01.2026

**“MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORIT ARENS ÇELA,
KANDIDAT QË KA KANDIDUAR PËR RIEMËRIM NË POZICIONIN E DREJTUESIT
TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 09.01.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Arens Çela, kandidat që ka
kandiduar për riemërim në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 04, datë 05.01.2026, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, dëgjoi Relatorin z. Erind Merkuri, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë dhe statusin e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 89, datë 06.05.2025 *“Për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e Drejtuesit në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. Arens Çela”*, Këshilli ka filluar verifikimin të pasurisë dhe figurës për prokurorin Arens Çela, i cili ka kandiduar për riemërim në pozicionin e Drejtuesit në këtë zyrë të prokurorisë.

Në vijim, me Vendimin nr. 89, datë 06.05.2025, *“Për caktimin me short të Relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi” i ndryshuar*, Këshilli ka caktuar me short Relatorin për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin. Pas procedurës së shortit rezultoi se, z. Erind Merkuri, anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale është në cilësinë e Relatorit në këtë procedurë.

3. Mandati 3 (tre)- vjeçar i prokurorit Arens Çela, si Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka përfunduar në datë 10.10.2025.
4. Me Vendimin nr. 308, datë 10.10.2025 *“Për caktim të përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”*, të Këshillit, z. Çela është caktuar të vijojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri me datë 11.01.2026.
5. Në zbatim të Pikave 1 dhe 2, të Seksionit B, të Kreut V, dhe të Seksionit A, Kreu VI, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 *“Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”*, i ndryshuar, *(në vijim Rregullorja)*, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale ka njoftuar në rrugë elektronike *(me e-mail)* në datë 07.05.2025, kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e Relatorit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.

Në përgjigje të njoftimit, kandidati Arens Çela me e-mailin e datës 07.05.2025, ka bërë me dije marrjen e e-mailit dhe ka konfirmuar faktin, se nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit me Relatorin apo ndonjë anëtar tjetër të Këshillit.

6. Në vijim, në datë 13.05.2025, Relatori i ka dërguar kandidatit në rrugë elektronike (*me e-mail*) formularët dhe autorizimet përkatës, me qëllim verifikimin nga ana e Këshillit, të të dhënave që lidhen me pasurinë dhe figurën e tij.
7. Me Shkresën regjistruar me nr. 1331 Prot, datë 14.05.2025, kandidati Arens Çela ka depozituar pranë zyrës së Protokollit, Autorizimin dhe Deklaratat standarde për kandidim për riemërim, për një mandat të dytë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shoqëruar me dokumentet si vijon:
 1. *Autorizimi datë 14.05.2025, Këshillit të Lartë të Prokurorisë për sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;*
 2. *Deklaratë datë 14.05.2025, me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;*
 3. *Deklaratë datë 14.05.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;*
 4. *Deklaratë Individuale datë 14.05.2025, që kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;*
 5. *Formular Vetëdeklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";*
8. Në mbështetje të neneve 32, dhe 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe germës "ç", të Kreut II, të Rregullores janë ndjekur veprimet procedurale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit Arens Çela.
9. Pas verifikimeve paraprahe dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet përgjegjëse shtetërore, Relatori ka paraqitur para Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Relacionin me gjetjet paraprahe si dhe sugjerimet përkatëse.

VERIFIKIMI I PASURISË SË KANDIDATIT.

10. Me Shkresën nr. 1420 Prot, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim, ILDKPKI*), për verifikimin e pasurisë për kandidatin Arens Çela.

Me shkresën nr. 114/23 datë 18.12.2025, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratave të Interesave Private të subjektit Arens Çela magistrat, kandidat për Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, ILDKPKI ka njoftuar Këshillin duke i vënë në dispozicion aktin e kontrollit. Sipas këtij akti kontrolli, në mënyrë të përmbledhur rezulton, se referuar të dhënave të deklarave të pasurisë dhe interesave private, kandidati ka deklaruar deri në datë 02.06.2025, si më poshtë:

1. Apartament banimi me sip.121. 2 m², Rr. “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, në vlerën 15.800.000 lekë. Zotëron 100% me b/shorten.
2. Garazh me sip. 20 m², në vlerën 1.000.000 lekë. Zotëron 100% me b/shorten.
3. Autoveturë tip “Mercedes”, në vlerën 3.000 euro, në emër të b/shortes.
4. Llogari page në BKT, në emër të b/shortes, në vlerën 672.294 lekë.
5. Llogari page ne Credins Bank në emër të kandidatit, në vlerën 20.027 lekë.
6. Depozitë në Credins Bank, në emër të kandidatit, në vlerën 133.006 euro.

Vlera e pasurisë bruto/neto është 17.492.321 lekë +136.006 euro, e konvertuar rreth 30.869.000 lekë.

Konvertuar në kursin e këmbimit të BSH, 1 euro + 98.35 lekë, dt. 2.06.2025

11. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ILDKPKI ka konstatuar, se për subjektin Arens Çela:

- a) **deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;**
- b) **ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) **nuk ka kryer fshehje të pasurisë;**
- d) **nuk ka kryer deklarim të rremë;**
- e) **kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.**

12. Me Shkresën nr. 1409, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Agjencisë së Inteligjencës Financiare, duke kërkuar informacion, nëse kandidati Arens Çela ka kryer transaksione apo disponon pasuri të dyshimta. Nëse po, është kërkuar të dërgohen të dhënat, si dhe dokumentacioni përkatës.

Në përgjigje, Agjencia e Inteligjencës Financiar ka informuar se: *nga kërkimi në sistemin elektronik nuk rezulton që kandidati Arens Çela të ketë kryer transaksione apo disponon pasuri të dyshimta.*

13. Me Shkresën nr. 1413, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*në vijim, DPT*), duke kërkuar informacion, nëse kandidati Arens Çela, rezulton i regjistruar si subjekt tregtar, dhe nëse po, është kërkuar të informohet Këshilli, në lidhje me:

- *Të ardhurat e realizuara nga ky subjekt përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar aktivitetin, duke na dhënë informacion të saktë, lidhur me fitimin neto, për çdo vit të ushtrimit të aktivitetit;*
- *Kopje të pasqyrave financiare dhe deklaratave të Tatimit të Thjeshtuar mbi Tatimin, TAPBV apo të Tatim Fitimit të dorëzuara nga subjekti, për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri më sot.*

Në përgjigje, me Shkresën nr. 9520/1, datë 02.06.2025, DPT ka informuar se: **pas verifikimeve të kryera, rezulton se z. Arens Çela, nuk figuron të jetë i regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.**

14. Me shkresën nr. 1412, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (*në vijim, DPD*), duke kërkuar informacion nëse, kandidati Arens Çela ka kryer veprime importi, eksporti apo kalimi tranzit të mallrave nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe nëse po, është kërkuar të dërgohen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të dhënat dhe dokumentacioni përkatës.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, DPD, me Shkresën nr. 10915/1, datë 11.06.2025, ka informuar se pas verifikimit në sistemin elektronik ASYCUDA WORLD, rezultoi se: *shtetasi Arens Çela nuk ka kryer asnjë procedure doganore import-eksport.*

Sa lidhet me informacionin që administrohet nga Drejtoria Antitrafik, nuk rezultojnë të dhëna për deklarime për para CASH, çek apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar, për shtetasen Arens Çela, për periudhën mars 2004 deri më datë 22 maj 2025.

15. Pas përgjigjeve të ardhura nga këto institucione dhe verifikimit të kryer, arrijmë në përfundimin, se ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatit të kontrolluar, raportit të përgatitur nga ILDKPKI-ja, si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme. Në këtë mënyrë, Relatori ka konkluduar se nuk ka nevojë të kryhet një hetim më i thelluar se ai i kryer nga ILDKPKI-ja.

II- VERIFIKIMI I FIGURËS SË KANDIDATIT.

16. Për verifikimin e figurës së kandidatit Arens Çela, me Shkresën nr. 1419, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke kërkuar informacion, nëse për kandidatin Arens Çela kanë pasur:

- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;*
- *Materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim, ku kallëzimi ka qenë në ngarkim të këtij shtetasi.*

Nëse po, është kërkuar të përcillet pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kopje e njehsuar me origjinalin e praktikës përkatëse. Nëse për kallëzime/procedime ka pasur ankime ose vendimmarrje nga gjykatat, është kërkuar të përcillen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kopje të vendimeve të gjykatave, deri në marrjen formë të prerë të tyre.

Në përgjigje, me Shkresën Nr.20221, datë 12.06.2025, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kthyer përgjigje, se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, për shtetasin Arens Çela nuk rezulton të jenë regjistruar procedime penale për periudhën 08.07.2022 – aktualisht. Në emër të këtij subjekti rezultojnë disa kallëzime penale, si vijon:

- i. Kallëzim penal nr. 167, i vitit 2023, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi" të këtij procedimi penal, më datë 27.07.2023.
- ii. Kallëzim penal nr. 203, i vitit 2023, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi", të këtij procedimi penal, më datë 28.09.2023.
- iii. Kallëzim penal nr. 136, i vitit 2024, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi", të këtij procedimi penal, më datë 25.07.2024.
- iv. Kallëzim penal nr. 149, i vitit 2024, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi", të këtij procedimi penal, më datë 31.07.2024.
- v. Kallëzim penal nr. 266, i vitit 2024, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi", të këtij procedimi penal, më datë 03.12.2024.
- vi. Kallëzim penal nr.49, i vitit 2025, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi" të këtij procedimi penal, më datë 10.03.2025.
- vii. Kallëzim penal nr.54, i vitit 2025, për të cilin pas verifikimit, prokurori i çështjes ka vendosur "vendim mosfillimi" të këtij procedimi penal, më datë 2.04.2025.

17. Me shkresën nr. 1418, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, nëse për kandidatin Arens Çela disponohet kopje e dokumentacionit në lidhje me ankesat dhe kallëzimet e qytetarëve të depozituar pranë institucionit tuaj. Nëse "po", lutemi të përcillen kopje të njehsuar me origjinalin të praktikës përkatëse.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 792/11, datë 18.06.2025, Prokuroria e Përgjithshme ka kthyer përgjigje, duke informuar se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave rezulton, se ndaj prokurorit Arens Çela janë regjistruar praktikat, ankesa si vijon:

- Me Shkresën nr. 536, të vitit 2022 është regjistruar ankesa e shtetases Rajana Jata me lëndë: “Njoftim mbi disa probleme të ndodhura në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, për të cilën është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme me anë të Shkresës nr. 536/5 datë 11.10.2022.
- Ankesë nr. 242 prot., e vitit 2023, e shtetasit Vilson Çobani, e cila është përcjellë për kompetencë në Prokurorinë e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Shkresën nr. 643/4 date 03.04.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme.

18. Me Shkresën nr. 1408, datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar të gjitha Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke kërkuar informacion, nëse për kandidatin Arens Çela kanë pasur:

- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;*

- *Materiale kallëzuese të mos-filluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim, ku kallëzimi ka qenë në ngarkim të kësaj shtetase.*

Nëse po, është kërkuar të përcillet pranë Këshillit kopje e njehsuar me origjinalin e praktikës përkatëse. Nëse për kallëzime/procedime ka pasur ankime ose vendimmarrje nga gjykatat, është kërkuar të përcillen kopje të vendimeve të gjykatave, deri në marrjen formë të prerë të tyre.

Në përgjigjet e ardhura nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm: Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë, Kukës, Shkodër, Sarandë, Gjirokastrë, Berat, Dibër dhe Lezhë informohemi se : *shtetasi Arens Çela nuk rezulton të jetë i përfshirë direkt apo indirekt në veprime të dyshimta, nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshëm dhe nuk ka materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo dërguara për gjykim.*

-Me Shkresën nr. 2233/1, datë 03.06.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka informuar, se lidhur me kandidatin Arens Çela është regjistruar një kallëzim penal me nr. 4345, datë 29.12.2022, për të cilin pas verifikimit, prokurori ka vendosur mosfillimin e këtij procedimi penal në datë 11.01.2023.

19. Me Shkresën nr. 1405 prot., datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke kërkuar informacion, nëse për kandidatin Arens Çela, ka pasur apo ka në ngarkim të tij çështje penale në gjykim. Nëse “po”, ju lutemi të përcillet kopje e vendimit të njehsuar me origjinalin ose të informohet për fazën në të cilën ndodhet gjykimi.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 2098, datë 02.06.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konfirmohet se, pas verifikimeve të kryera në sekretarinë e gjykatës, rezulton se në lidhje me shtetasin Arens Çela, *nuk ka çështje penale në ngarkim të tij nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*

20. Me Shkresën nr. 1405 prot., datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke kërkuar informacion, nëse për kandidatin Arens Çela ka pasur apo ka në ngarkim të tij çështje penale në gjykim. Nëse “po”, të përcillet kopje e vendimit të njehsuar me origjinalin ose të informohet për fazën në të cilën ndodhet gjykimi.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 9771/1, datë 27.05.2025, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konfirmon, se pas verifikimeve të kryera në regjistrat që disponojnë në lidhje me shtetasin Arens Çela, *nuk rezulton të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal. Ndaj tij nuk është marrë vendim për të zbatuar/revokuar/shuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror. Nuk ka të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara, vendime dënime apo pafajësie, në të cilat përmendet emri i kandidatit në proces verifikimi.*

21. Me Shkresën nr. 1406 prot., datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duke kërkuar informacion, nëse për kandidatin Arens Çela, ka pasur apo ka në ngarkim të tij çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershme. Nëse “po”, të përcillet kopje e vendimit të njehsuar me origjinalin ose të informohet në lidhje me fazën në të cilën ndodhet gjykimi.

Në përgjigje, me shkresën Nr. 11863/1 datë 26.05.2025, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm konfirmon, se pas verifikimeve të kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) në lidhje me shtetasin: *Arens Çela, nuk rezulton e regjistruar/gjykuar çështje gjyqësore civile/penale nga periudha 08.07.2022-26.05.2025.*

22. Me Shkresën nr. 1406 prot., datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm duke kërkuar informacion, nëse për kandidatin Arens Çela ka pasur apo ka në ngarkim të tij çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër

mbrojtje të menjëhershme. Nëse “po”, të përcillet kopje të vendimit të njehsuar me origjinalin ose të informohet në lidhje me fazën në të cilën ndodhet gjykimi.

Në përgjigje, Gjykatat pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm: Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, Elbasan, informojnë, se: *për shtetasin Arens Çela, nuk rezulton të ketë pasur apo të ketë në ngarkim të tij çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm.*

23. Me Shkresën nr. 1416 prot., datë 23.05.2025, Këshilli i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, nëse kandidati Arens Çela rezulton i regjistruar si ortak apo aksioner pjesëmarrës në ndonjë shoqëri. Nëse “po”, të dërgohet informacion të detajuar, për sa kërkohet.

Në përgjigje, me Shkresën nr. 10768/1 datë 28.05.2025, Qendra Kombëtare e Biznesit ka informuar, se: *shtetasi Arens Çela nuk figuron të jetë pajisur me NUIS (NIPT) i regjistruar si ortak apo aksioner pranë Regjistrat Tregtar.*

RAPORTIMI NGA SHËRBIMET SHTETËRORE INFORMATIVE.

24. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidatin Arens Çela, iu kërkua zyrtarisht informacion shërbimeve informative shtetërore.

Me Shkresën nr. 1414, datë 13.05.2025, të Këshillit drejtuar Shërbimit Informativ Shtetëror është kërkuar, nëse për kandidaten Arens Çela disponohen:

- *Të dhëna apo indicje për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;*

- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

Në përgjigje, Shërbimi Informativ Shtetëror, ka informuar se për kandidatin Arens Çela:

- Nuk disponohen të dhëna të përditësuara apo indice për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Nuk disponohen të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”).

funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

Me Shkresën nr. 1411, datë 23.05.2025, të Këshillit drejtuar Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është kërkuar, nëse për kandidaten Arens Çela disponohen:

- *Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve, në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;*
- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

Në përgjigje, me Shkresën nr. 2130/1, datë 16.06.2025, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme informohet, se pas verifikimeve të kryera për shtetasen Arens Çela, rezulton:

-Nuk ka të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.

-Nuk ka të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

Me Shkresën nr. 1410, datë 23.05.2025, të Këshillit drejtuar Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes është kërkuar, nëse për kandidatin Arens Çela disponohen:

- *Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;*
- *Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.*

Në përgjigje, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes ka informuar se, pas verifikimit të kryer, për kandidatin Arens Çela, *nuk disponohen të*

dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

25. Me shkresën Nr. 1415 prot., datë 23.05.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit me kërkesë, nëse kandidati Arens Çela rezulton e regjistruar si subjekt tregtar. Nëse ”po”, është kërkuar të na dërgohen informacioni i detajuar.

Në përgjigje, Qendra Kombëtare e Biznesit me Shkresën nr. 796/1 prot., datë 10.06.2025 ka informuar, se: *shtetasi Arens Çela nuk rezulton të jetë pajisur me NUIS (NIPT), si person fizik, juridik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare, të regjistruara pranë Regjistrat Tregtar.*

26. Përsa më sipër, nga përgjigjet e ardhura nga institucionet e sipërcituara rezulton, se për kandidatin Arens Çela:

- *Nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitetet të kundërligjshme;*
- *Nuk figuron i regjistruar për veprimtari kriminale.*

27. Sa më sipër, gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidatin Arens Çela nuk kanë rezultuar të dhëna që tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

III- KUSHTE TË TJERA LIGJORE

28. Me qëllim verifikimin, nëse në ngarkim të kandidatit ka pasur procedim disiplinor dhe cila ka qenë vendimmarrja përfundimtare për këtë procedurë, nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në Këshill jemi njohur me dosjen personale të prokurorit Arens Çela. Nga dokumentacioni i ndodhur në dosjen e kandidatit, u konstatua se me Vendimin nr. 206, datë 21.09.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për fillimin e hetimit disiplinor”, rezultoi të ketë filluar një hetim disiplinorë ndaj prokurorit Arens Çela, dhe me Vendimin datë 14.12.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi përfundimin disiplinorë në ngarkim të prokurorit Arens Çela, me detyrë prokuror në prokurorinë pranë Krimeve të Rënda”, është vendosur:

- Mbyllja e hetimit disiplinor në ngarkim të prokurorit Arens Çela.
- Materialet e hetimit disiplinor të depozitohen në sekretarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kandidati Arens Çela përfundoi Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës dhe ka marrë titullin “Jurist” në vitin 2003.

Duke iu referuar të dhënave të dosjes personale, konstatohet se kandidati ka eksperiencë pune si Prokuror, në prokurori të ndryshme, si vijon:

Me Dekret të Presidentit të Republikës nr. 5053, datë 04.10.2006, z. Arens Çela është emëruar prokuror në stazh, në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Me Dekretin nr. 5542, datë 11.12.2007, z. Arens Çela është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Me Dekretin nr. 6035, datë 29.01.2009, z. Arens Çela është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 109, datë 03.04.2013, z. Arens Çela është ngritur në detyrë, si Drejtues prokurorie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Me Dekretin nr. 9167, datë 13.07.2015, z. Arens Çela me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, transferohet prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.

Me Dekretin nr. 9424, datë 18.02.2016, z. Arens Çela me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, emërohet prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 03/2, datë 18.02.2016, z. Arens Çela është caktuar në Njësinë e Hetimit të Korrupsionit dhe Pasurisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Me Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 109, datë 17.03.2016, z. Arens Çela me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, emërohet në detyrën e Zv/Drejtuesit, si dhe Drejtues në Sektorin e Hetimit të Korrupsionit dhe Pasurisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Me Vendimin nr. 236, datë 12.12.2019, të Këshillit, z. Arens Çela me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda transferohet prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shkak se prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda pushon së ekzistuari më datë 19.12.2019.

Me Vendimin nr. 08, datë 20.01.2020, të Këshillit, z. Arens Çela, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, komandohet në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Me Vendimin nr. 83, datë 28.04.2022, të Këshillit është miratuar përfundimi para afatit i kohëzgjatjes së komandimit, miratuar me Vendimin e Këshilli të Lartë të Prokurorisë nr. 08, datë 20.01.2020, z. Arens Çela.

Me Vendimin nr.84, datë 28.04.2022, të Këshillit, z. Arens Çela prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është caktuar përkohësisht të ushtrojë funksionin si Drejtues, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Me Vendimin e Këshilli nr. 264, datë 11.10.2022, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele z. Arens Çela është emëruar Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me Vendimin nr. 359, datë 23.03.2021 ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arens Çela.
- Institucioni i Komisionerit Publik njofton se nuk është ushtruar ankim për këtë subjekt në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

29. Në konkluzion të këtij Relacioni me gjetjet e procedurës administrative të verifikimit të pasurisë dhe figurës, si dhe analizës së mësipërme, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale i propozoi Këshillit:

1. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së prokurorit Arens Çela, kandidat që ka kandiduar për t'u riemëruar Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas përcaktimeve të neneve 32 dhe 52, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Lejimin e kandidatit Arens Çela të vijojë me procedurat e mëtejshme, për riemërim në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenet 32 dhe 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 166, dhe 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI dhe pikat 1, 2, 11 dhe 12, Seksioni B të Kreut VI, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", i ndryshuar, dhe në nenet 7 dhe 9, pika 5 të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, "Për miratimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm", të Këshillit, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së prokurorit Arens Çela, kandidat që ka kandiduar për t'u riemëruar Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Lejimin e kandidatit Arens Çela të vijojë me procedurat e mëtejshme për riemërim në pozicionin Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Të njoftohet për këtë vendim prokurori Arens Çela.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 09.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla